

**FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS**

**- K U V E N D I -**

**D O K U M E N T I  
PËR ZHVILLIMK STRAETGJIK TË BASKETBOLLIT**

**PRISHTINË,12 SHTATOR 2009**

# PARATHËNIA

EROLL D BELEGU, President i FBK

U mbush një dekadë që kur basketbolli kosovar është duke bërë përpjekje për të u konsoliduar si sporti numër 1 në Kosovën e pasluftës. Dhe në disa periudha jo vetëm që u bë sporti numër 1, por dukshëm i la mbrapa sportet tjera si për nga cilësia, atraktiviteti, publiku, masivizimi e deri të shumta e investimeve në sport.

Mirëpo, ajo që me një shikim sipërfaqësor bie në sy është luhatshmëria në zhvillimin e tij, kishte momente kur shumica e klubeve kosovare mbështetej nga elita e biznesit kosovar deri në momente kur të njëjtët klube vinin në pikëpyetje dhe vet ekzistencën, e besa disa edhe shuheshin tërësisht (psh. Mabetxx, As Prishtina, Ekskluzive, Universiteti, etj).

Pas ndryshimeve në kreun e FBK në prill të vitit 2006 në vazhdimësi u kërkua forma më e përshtatshme për zhvillim të hovshëm të basketbollit, duke ndryshuar sistemin e garave, duke kufizuar numrin e lojtarëve të ri, duke themeluar Ligat e pionierëve, duke riorganizuar Ligat e Juniorëve dhe kadetëve, duke organizuar kampet zyrtare të Federatës së Basketbollit të Kosovës.

Gjendja në basketbollin kosovar është larmishme. Kemi disa klube të suksesshme, kemi publik (sidomos në përfundimtare të kampionatit dhe Kupës), kemi numër të shtuar të shkollave të basketbollit që rezultojnë me rritje të lojtarëve të rinj, kemi lojtarë të rinj të cilët kanë kaluar në klube me renome evropiane. Është rritur dukshëm numri i lojtarëve që rinj që kanë perspektivë të ndritshme në këtë sport.

Mbetja jashtë anëtarësimit në FIBA, ka krijuar vështirësi të mëdha edhe në planin e brendshëm. Përpjekjet për anëtarësim ende nuk dhanë rezultat, por ajo ditë nuk është larg.

Andaj, Kuvendi i FBK ka parë të arsyeshme që të gjejnë forma dhe metoda të reja, për një depërtim më të madh të basketbollit në Kosovë, në mënyrë që rritja e basketbollit të jetë e koordinuar, planifikuar dhe afatgjatë.

Për realizimin më të qëllimi është hartuar ky dokument për zhvillimin strategjik të basketbollit i cili duhet të shërbejë si bazë për realizimin e misionit tonë të përbashkët: zhvillimin dhe ngritjen e tij në nivelet më të mira të mundshme.

## **1. HYRJE**

Pasiqë kontradiktat në sport ndajnë fatin e shoqërisë, kjo mënyrë e qasjes dhe propozimeve, në kërkim të zgjidhjeve optimale, duhet kuptuar si nxitje në të cilën asnjë mendim i shprehur nuk paraqet fund të idesë.

Ky dokument për zhvillim strategjik nuk mëton të jetë një dokument statik, i shkruar njëherë dhe i pakontestueshëm përherë. Përkundrazi qëllimi i këtij dokumenti është që për herë të parë në formë të shkruar ta kemi një përcaktim të përbashkët rreth angazhimeve të përbashkëta për të krijuar një kohezion dhe bashkërenditje të të gjitha organeve, organizatave dhe strukturave të domosdoshme për realizimin e vizionit dhe qëllimit të ngritjes së sportit të basketbollit në majat më të larta të mundshme, duke u bazuar në rrethanat tona të përgjithshme shoqërore, ekonomike, e të tjera.

Nga ky dokument është e domosdoshme që të rezultojnë shumë programe dhe projekte konkrete në të gjitha rrafshet r organizimit të sportit të basketbollit dhe sportit në përgjithësi në Republikën e Kosovës.

Ky dokument për zhvillim strategjik lindi si nevojë e për një qasje tjetër të shoqërisë kosovare karshi sportit, i cili edhe pas dhjetë vjetëve, ballafaqohet me shumë probleme organizative, ligjore, infrastrukturore, profesionale, materiale ...

## **2. HISTORIKU I BASKETBOLLIT NË KOSOVË**

Basketbolli në Kosovë daton qysh nga viti 1942. Njëri ndër propaganduesit e parë të basketbollit ishte HAJRULLAH MORINA (lindi më 1921 në Gjakovë). Si duket ai edhe e solli topin e parë të basketbollit nga Italia. Ishte edhe mësimdhënës i Edukatës Fizike në Prizren ku edhe e futi lojën e basketbollit në programin mësimor. Në muajin maj të vitit 1942 u vendosën edhe koshat në oborrin e shkollës së gjimnazit të Prizrenit, vijat anësore dhe fundore kanë qenë prej guralecëve të bardhë, kurse vijat e brendshme janë shënuar me gëlqere. Tabelat e para prej drurit kanë qenë të ngjitura në dy shtylla të telefonit të ngjuara pranë vijave fundore. Me vendosjen e koshave është luajtur edhe loja e parë në mes të policisë fashiste italiane e quajtur “FEDERAT”.

Basketbolli pas luftës së Dytë Botërore fillon të përhapej njëkohësisht edhe në qytetet tjera të Kosovës. Në fillim formohen seksione e më vonë shndërrohen në skuadra të basketbollit, si në Prishtinë, Gjakovë, Pejë, Ferizaj, Mitrovicë etj.

Garat me sistem lige kanë filluar të mbahen prej vitit 1955. Më vonë formohet Lidhja e Basketbollit të Kosovës.

Fushat në atë kohë, 1945 – 1948 kanë qenë prej dheu. Garat e basketbollit në Kosovë mbahen në fusha të asfaltuara prej vitit 1958.

Prej viti 1979 Basketbolli zhvendoset në Palestra të mbyllura.

Deri në vitin 1991 Kosova ka funksionuar si pjesë e Lidhjes së Basketbollit të Jugosllavisë

Më 31 tetor 1991 u themelua Federata e Pavarur e Basketbollit të Kosovës.

Më 7 nëntor 1991 u zhvillua xhiroja e parë e kampionatit në fshatin Bellanicë, ku morën pjesë 8 ekipe. Në vitin 1998 lufta për çlirim nga okupatori ndërpreu edicionin garues 1997/98.

Pas çlirimit basketbolli morri zhvillim të hovshëm dhe tash për tash është ndër sportet më të dashura dhe më të popullarizuara në vend.

### **3. ANALIZA E GJENDJES MOMENTALE NË BASKETBOLL**

#### **- Infrastruktura ligjore**

Infrastruktura e vetme e këtij lloji është: **Ligji për sportin**, që është aprovuar me 20.11.2003 në Kuvendin e Kosovës, dokument që pos formës së përgjithshme përkrahëse, nuk i ka shërbye sportit për ndonjë avancim praktik.

Sigurisht se mungesa e normave të mirëfillta, kritereve të qarta, statusit, formës dhe mënyrës së financimit, ka sjellë sportin në pozitë jo të lakmueshme, si çështje mbi të gjitha çështjet që rëndon këtë segment. Edhe pse **neni 13** i ligjit për sportin cakton se: *"institucionet publike të të gjitha niveleve, veçanërisht ato kompetente të kujdesën për trajtimin, mirëmbajtjen dhe mbështetjen financiare të edukimit fizik e sportit"* por në përditshmërinë tonë (së paku kështu ishte deri tani), hasim në paqartësi, pengesa e ndalesa të llojllojshme objektive e subjektive dhe shpeshherë sporti ka trajtimin marginal deri në ekstrem.

#### **- Financimi i basketbollit**

Financimi i basketbollit tash e 10 vjet ishte çështja me e ndjeshme, e cila në masë të madhe ndikoj në format e aktivitetit, punës dhe angazhimit të përgjithshëm në këtë sport. Financimi deri tani ishte vullnet apo simpati i një individi (privat apo shoqërorë) për të ndihmuar materialisht basketbollin si SPONZOR (ishin shumë pak) dhe DONATOR të momentit –ad hoc (numerikisht më shumë). Institucionet shtetërore të nivelit **qendror** dhe **lokal –komunal**, ndihmuan aq sa për këtë lejuan mjetet, por edhe vullneti dhe botëkuptimi i zyrtarëve institucional për të mbështet degën e caktuar sportive, pastaj edhe

niveli basketbollit (renditja tabelore e skuadrës),masivitetit,numrit të kategorive pjesëmarrëse në gara.

Prindërit ishin një segment veçante(edhe pse modest) i financimit të aktivitetit të basketbollit sidomos në këto 2-3 vitet e fundit me angazhimin e kategorive e reja (te meshkujt).

FBK përmes formave të ndryshme (Deklaratës së Kuvendit të FBK,pjesëmarrjes në Komisione për hartimin e ligjit,etj) është përpjekur të ndikojë në aprovimin e Ligjit për sponsorizim,por mjerisht pa rezultat.

## - Infrastruktura sportive

Objektet ose infrastruktura sportive për basketbollin në Kosovë është shumë e kufizuar, kryesisht është e amortizuar, e vjetër dhe shumë e papërshtatshme. Palestrat ose sallat për edukatë fizike pranë shkollave fillore dhe aty këtu ndonjë nëpër shkolla të mesme,ishin në të shumtën objekte ku sporti basketbollit kosovar zhvilloi aktivitetin e vet edhe në periudhën e sportit paralel 1991-1998, pasi pallatet e sporteve ishin objekte qe nuk u shfrytëzuan si masë ndalimi nga pushteti aktual serb ndaj sportit shqiptar. Kosova, këto objekte (sallat e shkollave) u trashëguan nga vitet e gjashtëdhjeta apo të shtatëdhjeta të shekullit të kaluar. Ato kryesisht janë të dimensioneve shumë të vogla, kurse tabelat e koshit shumë afër murit të sallës,çka paraqet rrezik permanent për lëndime të fëmijëve dhe ushtruesve. Tabelat e koshit dhe dyshemetë (parketi) i 90 % i sallave janë kryesisht në gjendje shumë të keqe. Zhveshtoret dhe nyjet sanitare (banjot wc) shpeshherë paraqesin rrezik për infektim,pasi në to nuk është intervenua jo me vite, por me shumë dekada.. Pas lufte sallat e shkollave shërbyen kryesisht për shkolla të basketbollit për kategori të reja, kurse 7 pallatet e sportit për aktivitetin e skuadrave seniore.(por jo vetëm për basketboll) Në periudhën e pas lufte (për 10 vjet) në Kosovë për qëllime të sportit(edhe basketbollit) u ndërtuan disa pallate sportive,por mjaft të gjymtuara,e disa vetëm u filluan.

## - Klubet

Me Ligjin mbi Sportin klubet sportive mund të jenë publike dhe private.Në basketbollin kosovar të gjitha klubet që bëjnë gara aktualisht janë klub publike. Ka pasur tentativa për të themeluar klube private ,të cilat shumë shpejt janë fikur apo janp regjistruar si private. Klubet e marrin statusin e klubit publik me regjistrim si OJQ dhe regjistrim në Drejtorinë komunale.

Në klube kemi situata paradoksale,aty ku ka mjete financiare mungojnë organet e domosdoshme për Klube publike,aty ku ka organe nuk ka mjete të mjaftueshme financiare.

Një ndër çështjet që më së shumti e rëndon basketbollin kosovar është mos qëndrueshmëria e klube, Ekipi kampion i Kosovës i para 5 viteve nuk ekziston më. Shumë klube u shuan me shpejtësi meteori ndërsa disa klube me renome janë në pikëpyetje të zhbëhen përgjithmonë.

## - Shkollat e basketbollit

Në Kosovë është rritur dukshëm numri i shkollave të basketbollit qoftë panë klubeve qoftë si shkolla të pavarura. Edhe pse flitet shumë se janë shkolla private ato në përgjithësi janë shkolla të regjistruara si OJQ, pra publike. Në të shumtën e rasteve ato mbahen nga një eventualisht dy individ (trajnerë) dhe kryesisht jetojnë nga vjelja e anëtarësisë nga vijuesit e shkollës. Kjo ka ndikuar që numri i vijuesve në shkolla të rritet skajshmërisht pa i kushtuar kujdes cilësisë dhe normave sportive. Kështu që një pjesë e këtyre shkollave më shumë i përngjan çerdheve për fëmijë (qëllimeve josportive - kalimit të kohës së lirë, humbjes së peshës - dobësimi, etj.) sesa një shkollë të vërtetë të basketbollit. Megjithatë shkollat e basketbollit kanë arritur të aftësojnë një numër të lojtarëve të talentuar.

## - Lojtarët

Statusi i lojtarëve kosovar pas luftës ka ndryshuar shumë herë. Nga lojtarë amator deri në “rezervistë” (kryesisht) të paguar jashtëzakonisht shumë për kushte kosovare. Nga lojtarë që kanë dominuar basketbollin kosovar në lojtarë që nga banka kanë përcjell lojën e bashkë lojtarëve të ardhur nga jashtë. Për momentin ka lojtarë të paguar mirë, lojtarë të paguar pak dhe lojtarë tipik amator, që edhe pajisjet sportive i blejnë nga xhepi.

Kemi vërejtur disa dukuri sa i përket lojtarëve, të cilët e përfundojnë moshën e juniorit dhe nuk kanë hapësirë për të kaluar në ekipin e parë. Një është mungesa e ekipeve “kushtimisht” të vogla ku do të kaliteshin dhe e dyta përcaktimi për studime jashtë vendbanimit. Në të dyja rastet rezultat është braktisja e lojës.

Sot numri i lojtarëve kosovar që luajnë jashtë Kosovës, është në rënje e sipër sa i përket sendorëve, ndërsa në rritje është numri i të rinjve që anëtarësohet në klubet jashtë Kosovës. Por kryesisht kjo shkuarje është e pakontrolluar fare.

## - Kuadrot profesionale

Kuadri profesional, është çështja më e rëndësishme pas kushteve materiale dhe të hapësirës për stërvitje ose infrastrukturës sportive. Dhjetë vitet paraluftës dhe izolimi i pas luftës kanë ndikuar që një numër i madh i kuadrove të mëhershme të humbin hapin

me të arriturat e basketbollit botëror,ndërsa të rinjtë të kenë pothuajse të pamundur shkollimin në avancimin në kushte moderne. Një pjesë e trajnerëve është krijuar afër Trajnerëve të Huaj që një kohë ishin në Kosovë,pjesa tjetër me vetiniciativë është shkolluar jashtë Kosovës,megjithatë mungesa e një strategjie të shkollimit ka lënë zbrazëtira të shumta. Megjithatë një numër i madh i të rinjve me Fakultet të Kulturës fizike janë përfshirë në basketboll,megjithatë vërehet mungesa e specializimeve për lojën e basketbollit.

## - Puna shkencore-hulumtuese në basketboll

Puna shkencore-hulumtuese në basketbollin kosovar është tejet e paktë,e ndoshta mund të flitet për mungesë të saj. Derisa në sporte tjera,posaçërisht në futboll ka botime të vazhdueshme të librave,në basketboll janë botuar dy libra dhe nuk është përkthyer asnjë. Ka zëra se shumë profesorë të edukatës fizike punojnë tema në master nga basketbolli,ato asnjëherë nuk e kanë parë dritën e botimit.

## - Basketbolli në shkolla dhe universitet

Dikur basketbolli në shkolla dhe në universitet ka qenë jashtëzakonisht prezent dhe i popullarizuar. Nga aty janë rekrutuar lojtarët e edhe gjyqtarët e basketbollit. Vitin e kaluar janë bërë përpjekje të garave në shkolla fillore dhe të mesme nga shoqata e Pedagogëve sportiv,ndërsa FBK paorganizuar Basketuniversiadën.

## - Garat

Zhvillimi i garave është në fokus të çdo adhuruesi të basketbollit. Është bërë përpjekje maksimale për ta rritur rivalitetin e garave të sendorëve,por edhe të rritet cilësia dhe kualiteti i të gjitha garave tjera,posaçërisht të kategorive të reja. Garën e kanë bërë tejet interesante ngulmimi i vazhdueshëm për rregullsi por këtë e ka vështirësuar mungesa e kushteve materiale,infrastrukturës së dobët(mungesa e nxehtësisë) por edhe dobësitë subjekteve të klubeve por edhe të trajnerëve për rezultate me çdo kusht,sidomos te kategoritë e reja.

## - Përfaqësueset

Sporti,një veprimtari aq e rëndësishme e shoqërisë dhe e popullit të një vendi, duhet të ketë tretmanin që e meriton,sepse ai është ambasadori më i mirë i një vendi në botën moderne.

Në pritje të anëtarësimit të sportit kosovar në institucione më të larta të sportit botëror, edhe basketbolli kishte prezantime modeste jashtë Kosove. Këto përfaqësime ishin një përvojë e mirë në kushtet dhe rrethanat në të cilat vepron basketbolli. Edhe pse thuhet se sporti duhet të qëndroj larg politikës, pikërisht politika ishte pengesë në dështimin e shumë synimeve por edhe projekteve që basketbolli kosovar i kishte planifikuar, nuk arriti për t'i realizuar. Kur kësaj i shtojmë edhe mosazhuritetin e shumë subjekteve tona të brendshme,atëherë përfaqësimi ynë në disa raste jashtë Kosove ishte më se i suksesshëm.

Përkundër shumë ndeshjeve të zhvilluara në këtë vit dhe Rregullores së aprovuar për Përfaqësuese,mund të themi se ende nuk kemi Përfaqësuese të konsoliduar në asnjë kategori

## - Konkluzioni i analizës

Vështrimi kritik në analizën e basketbollit kosovar që u vërejt më lartë,nuk ishte dëshirë e nxirjes së realitetit të basketbollit,i cili nga të tjerët vlerësohet shumë lartë në krahasim me sportet tjera në Kosovë,por ishte përpjekje për evidentim të dobësive më qëllim të rritjes e mobilizimit të çdo anëtari të Federatës nga lojtari,trajneri,gjyqtari,punëtori sportiv për të u angazhuar fuqishëm në gjetjen e rrugëve dhe formave për të pasuar ngritja rapide e mëtejme e këtij sporti kaq të dashur në Kosovë.

Tri aspektet e para të përmendura(infrastruktura ligjore,financimi dhe infrastruktura sportive) janë refleksion i gjendjes së përgjithshme në shoqëri dhe Federatat nuk kanë fuqi të zgjidhin këto çështje. Koordinator i këtyre lëvizjeve duhet të jetë Komiteti Olimpik i Kosovës,i cili përkundër përpjekjeve tona nuk ka treguar gatishmëri dhe dëshirë të merret me zgjidhjet e këtyre çështjeve.

## 4. VIZIONI I ARDHMËRISË SË BASKETBOLLIT KOSOVAR

Brenda një periudhe të shkurtër kohore shteti i Kosovës do të jetë anëtarë e barabartë me të gjitha shtetet tjera në institucionet ndërkombëtare, e rrjedhimisht edhe basketbollit kosovar do të behët pjesë e familjes botërore të basketbollit.

Nxënia e hapit me zhvillimet moderne të basketbollit dhe ngritja sa më e lartë në rangjet e garave të ndryshme rajonale, kontinentale dhe botërore me të gjitha kategoritë do të jenë cak i basketbollit kosovar.

## 5. QËLLIMI

Organizimi i basketbollit nga nivelet shkollore deri në basketbollin profesionist, cili përmes punës profesionale nga masiviteti do të kalonte në cilësi me të cilën sporti i basketbollit do të behej tërheqës në garat e brendshme dhe konkurrues në garat ndërkombëtare.

## 6. STRATEGJIA APO: SI TË ARRIHEN QËLLIMET

### - Ndikimi në infrastrukturën ligjore

Duhet shtuar trysnia në organet kompetente për ndryshim të Ligjit për sport dhe nxjerrjen e dy ligjeve të rëndësishme:

**1. Ligjin për sponsorim dhe**

**2. Ligjin për koncesion që lidhet me infrastrukturë sportive.**

### - Financimi

- Lehtësirat fiskale shtetërore
- Marketingu
- Vetëfinancimi

### - Ndikimi në infrastrukturën sportive

Përmes formave të ndryshme të ndikohet

- në ndërtimin palestrave ë reja
- meremetimin e palestrave ekzistuese
- ndërtimin e sallave të edukatës fizike
- meremetim e sallave të edukatës fizike
- vendosjen e tabelave të basketbollit në çdo hapësirë të mundshme

## - Bashkëpunimi me organet shtetërore dhe lokale

I tërë procesi i realizimit të këtij dokumenti strategjik është i pa konceptueshëm pa një Komitet Olimpik dinamik dhe funksional dhe pa bashkëpunim të vazhdueshëm me organet shtetërore, sidomos MKRS dhe Ministrinë e pushtetit lokal.

Ndryshimi i qasjes së pushtetit lokal, komunave, si bazë e organizimit shoqëror, ndaj sportit është i domosdoshëm për të realizuar vizionin dhe qëllimet e këtij dokumenti.

## - Qëndrueshmëria e klubeve

Për qëndrueshmëri të klubeve duhet që :

- të qartësohet pronësia e klubeve
- të organizohen konform ligjit
- të përcaktohet definicioni klub publik
- të formohen seksionet me kategori të reja

## - Shkollat e basketbollit

- të nxirret udhëzimi administrativ i MKRS për organizim të shkollave
- të qartësohet pronësia
- të diferencohen shkollat e mirëfillta prej atyre të rekreacionit
- të krijohet plan- program unik për punën e tyre

## - Lojtarët

- statusi i qartë profesional
- statusi i qartë amator
- dëmshpërblimi për kalim nga klubi në klub për lojtarët e moshës jomadhore
- mundësia e lojërave më të shumta për të rinjtë deri në 22 vjeç
- shkuarja e kontrolluar jashtë Kosovës

## - Sporti në shkolla dhe universitet

- të organizohen gara të rregullta shkollore
  - të organizohen gara të rregullta universitare
- Të punohet në themelimin e federatave sipas Ligjit për sport
- Federatës së basketbollit për nxënës
  - Federatës së basketbollit për studentë

## - Kuadrot profesionale për nevojat e kohës

- Organizimi i shkollimit të rregullt për kuadro të basketbollit
- Organizimi i aftësimit profesional plotësues
- Pjesëmarrja në aftësime profesionale afatshkurtra dhe afatgjata jashtë vendit
- Paisja me publikime të shkruara dhe elektronike me tema profesionale

## - Puna shkencore-hulumtuese në basketboll

- Aplikimi i metodave shkencore në klube dhe shkolla
- Editimi i publikimeve të shkruara dhe elektronike të ekspertëve vendor
- Përkthimi i literaturës botërore të basketbollit
- Editimi i një periodiku shkencor-profesional të basketbollit

## - Garat

Teoria e sportit thotë se gara :” ***është mjeti dhe qëllimi kryesor i sportit***”

- të mundësohet kënaqësia e garimit të gjithë të aftësuarve për gara,në nivelin ne moshës dhe përgatitjeve të përgjithshme

- Me rregulla dhe zbatimin teknik të i mundësohet fitorja më të mirëve dhe kështu të nxitet zhvillimi aftësive individuale dhe grupore për arritje kulminante dhe punë profesionale

- Me garim korrekt dhe fer-play të mundësohet “përfshirja” e publikut në gara
- në vazhdimësi duhet kërkuar sistemet e garave adekuat
- garat e kategorive të reja duhet ndryshuar prioritetin:

Prioritet:

1. Krijimi i lojtarëve cilësor
2. Rezultatet ekipore

## - Përfaqësueset

- Konsolidimi i të gjitha përfaqësueseve
- Përcaktimi i prioritetit të përfaqësueseve gjegjëse

## - Organizimi i manifestimeve ndërkombëtare

Synim i FBK është që pas anëtarësimit në FIBA të konkurroj për organizimin e ndonjë evenimenti të basketbollit evropian për kategori të reja,më qëllim të sensibilizimit dhe afirmimit të basketbollit në Kosovë.

## 7. HAPAT E MËTEJMË

Për zbatimin e këtij dokumenti për zhvillim strategjik është e domosdoshme

1. Përfshirja e të gjithë potencialit ekzistues kadrovik në basketbollin kosovar
2. Hartimi i plan-programeve të punës për tematikën gjegjëse
3. Bashkëpunim permanent me të gjitha segmentet shtetërore, lokale dhe shkencore
4. Ndryshimi i akteve normative në funksion të realizimit të qëllimeve strategjike
5. Formimi i komisioneve për realizimin e qëllimeve
6. Ndryshimet pozitive në organet më të larta sportive
7. Sigurimi i përkrahjes së mediave
8. Gjetja e mjeteve financiare për zbatimin e qëllimeve

Shënim:

Këtë dokument e punoi grupi punues në përbërje:

1. Isuf Lumi, Sekretar i Përgjithshëm i FBK
2. Nazmi Paçarada, Komesar i Garave në FBK
3. Jeton Nixha, Kretar i Këshillit Profesional të FBK
4. Arben Krasniqi, Kryetar i Shoqatës së Trajnerëve të Basketbollit të Kosovës

Në punim e këtij dokumenti kontribut të jashtëzakonshëm vullnetar dha punëtor i vjetër sportiv dhe pedagogu i sportit, Jakup Kasapolli të cilin grupi punues e falënderon publikisht.